

## **Termet e Referencës: Ekspert për Raport mbi statusin e bimëve medicinale në park**

### **1. Hyrje**

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, përmes Grantit PONT në Parkun Kombëtar të Alpeve Shqiptare (PA\_028), duke ndjekur planin operacional të dakordësuar për këtë zonë të mbrojtur, është e angazhuar në monitorimin dhe ruajtjen e specieve treguese si një komponent kyç i menaxhimit të përgjithshëm të zonës së mbrojtur së bashku me habitatet kryesore. Për të siguruar efektivitetin e përpjekjeve tona për ruajtje, ne po kërkojmë një ekspert me përvojë për të kryer një studim në lidhje me "Raport mbi statusin e bimëve medicinale në park".

### **2. Objektivat**

Objektivat kryesore të angazhimit të ekspertit janë si më poshtë:

- a. Të prodhojë një Raport mbi statusin e bimëve medicinale në park.

### **3. Qëllimi**

Eksperti do të jetë përgjegjës për:

Shtrirja përfshin një qasje, nga kuptimi i karakteristikave të habitatit dhe prodhimi i një Raporti mbi statusin e bimëve medicinale në parkun e Parkut Kombëtar të Alpeve Shqiptare, që do të ndihmojë RAPAt e Shkodrës dhe Kukësit në zbatimin e një plani veprimi për ruajtjen e statusit të bimëve medicinale.

### **4. Kohëzgjatja**

Konsulenca pritet të fillojë më 15 korrik dhe të përfundojë më 1 shtator. Detyra është e përqendruar në Parkun Kombëtar të Alpeve Shqiptare. Eksperti pritet të dorëzojë një Raport mbi statusin e bimëve medicinale në park, duke siguruar shpërndarjen gjeografike dhe të dhënat sasiore.

### **5. Raportimi**

Eksperti do të dorëzojë një raport tek Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura së bashku me rekomandimet.

### **6. Kualifikimet**

Kandidati ideal duhet të ketë:

- a. 5 - 10 vite përvojë në fushën e ekspertizës së biodiversitetit

- b. Ekspertizë të dëshmuar në përbërjen e habitatit dhe specieve të Parkut Kombëtar të Alpeve Shqiptare
- c. Njohuri me kontekstin ekologjik të zonës së projektit.

## **7. Buxheti**

Buxheti për konsulencën referohet linjave të buxhetit:

- Aktiviteti Nr. 3.1 "Raport mbi statusin e bimëve medicinale në park"

Duke bërë vlerën totale të kësaj konsulence 1020 Euro duke përfshirë 15% të taksave.

## **8. Procesi i Aplikimit dhe Afati**

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë një CV deri më 7 korrik në adresën [info@akzm.gov.al](mailto:info@akzm.gov.al)